



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:035447

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06324914

AA.nr.992/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtar, e me bashkëpunëtorin profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Dragusha, kundër të paditurës, Agjencia për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Nehat Pllana, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e palës paditëse, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.364/22, të datës;29.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;16.10.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës paditëse, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.364/22, i datës;29.11.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.364/22, të datës;29.11.2023, është vendosur, “*I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Nr.04/22 i datës 24.01.2022. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale*”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë pala e paditëse, Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të autorizuarit të saj, Fitim Dragusha, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të merret aktgjykim duke e aprovuar ankesën e paditëses si të bazuar, dhe të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar, ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses ose të merret aktvendim dhe të aprovohet ankesa e paditëses si e bazuar, dhe të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosije.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e palës paditëse është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton me vendimin e kontestuar me nr.04/22, të datës;04.01.2022, e paditura, Agjencia për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë, ka shqiptuar gjobë ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, në vlerë prej 20.000 euro (njëzetmijë), për përpunimin e kundërligjshëm të të dhënave personale, si dhe është urdhëruar, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, të bëjë largimin e listave me të dhënat personale të personave fizik, të cilat janë publikuar në web faqen zyrtare të saj, dhe të bëjë shkatërrimin e këtyre listave.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e kontestuar, me datë; 22.02.2022, ka ushtruar padi ndaj të paditurës, me të cilën ka kërkuar nga Gjykata që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e saj si të bazuar, të anulohet vendimi nr.04/22, i dt.24.01.2022, i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, si dhe të obligohet e paditura, që t'ia kthej Administratës Tatimore të Kosovës shumën e paguar në emër të gjobës në vlerë prej 20.000.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nga arsyet e dhëna në padi.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin ka refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadija e paditëses, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar. Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e përfaqësues të paditëses është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Gjykata gjeti se organi i paditur në mënyrë të drejtë e ka konstatuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale. Akti administrativ i atakuar, përmban të gjitha elementet e detyrueshme konform nenit 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjykata gjeti se në vendimin e atakuar nuk evidentohet asnjë shkelje e ligjit material, për faktin që mbi bazën e Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve, nuk përcaktohet asnjë dispozitë ligjore mbi bazën e së cilës mundësohet publikimi i numrit personal të personave, krahas publikimit të Listës së përfituesve për faljen e borxheve, me të cilin qytetarët do të mund të identifikoheshin. Gjykata gjeti se organet administrative tek paditësja, përgjegjëse për kontrollimin dhe publikimin e të dhënave personale për qytetarët, borxhet e të cilëve janë falur, me rastin e publikimit të këtyre listave, e së bashku me to edhe numrat personal të qytetarëve, ka rënë ndesh me nenin 4, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike, në të cilin qartazi përcaktohet si në vijim: “3. Institucionet Shtetërore dhe Ndërmarrjet Publike janë të obliguara t’i publikojnë, t’i mbajnë të publikuar dhe t’i azhurnojnë listat, sipas ankesave që mund të ushtrohen, sipas të gjeturave të Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjykata po ashtu gjeti se ndonëse qëllimi i përpunimit të të dhënave ka të bëjë me një detyrë të interesit publik, gjë të cilën paditësja sipas pohimeve të saj në padi edhe e ka synuar, e njëjta nuk ka arritur që këtë qëllim ligjor ta arrij duke përdorur metoda të përshtatshme për të shmangur publikimin e numrit personal të subjekteve të cilëve ju ka referuar. Rrjedhimisht, përpunimi i tillë i të dhënave, ndonëse ka pasur parasysh përfundimin e një detyre me interes publik, është përcjellë me

kundërligjshmëri, për çka e paditura me të drejtë e konform autorizimeve të veta ligjore, paditëses i kishte shqiptuar gjobën administrative si në dispozitiv të vendimit të atakuar me këtë padi. Duke marrë parasysh të gjitha ato që u thanë më lartë, gjykata erdhi në përfundim të qartë se organi i paditur ka vepruar në tërësi konform obligimeve që rrjedhin nga neni 132 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Paditësja me pretendimet e saj dhe provave të dorëzuara në gjykatë, nuk dëshmojnë një gjendje tjetër ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike. Andaj në këto rrethana tani të argumentuara, gjykata përfundimisht vlerësoi se vendimi i të paditurit është vendim i drejtë, i bazuar në dispozitat ligjore dhe me vërtetim të drejtë të gjendjes faktike, pasi që faktet e konstatuara janë në përputhje të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga provat e administruara edhe Gjykata konstatoi gjendje faktike të njëjtë me atë të konstatuar nga ana e të paditurës në vendimin e saj”.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje procedurale, sipas dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 se “kur aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare”. Sipas vlerësimit të kolegjit të Apelit, këto pretendime nuk qëndrojnë sepse Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të ligjit material se “vendimi i gjykatës është i mangët meqë nuk ka shqyrtuar fare çështjen se publikimi i listave me të dhënat e personave fizikë që kanë mundur të përfitojnë nga falja e borxheve ka qenë i nevojshëm për kryerjen e një detyre me interes publik dhe kështu është plotësuar kriteri i paraparë me nenin 5 par.1.5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas vlerësimit të kolegjit të Apelit, këto pretendime nuk qëndrojnë sepse Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, përkatësisht, Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 3 dhe 5 të tij lidhur me Ligjin Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve dhe Udhëzimin Administrativ Nr.04/2015 për Procedurat e Faljes së Borxheve Publike, kur ka nxjerrë përfundim se “Gjykata po ashtu gjeti se ndonëse qëllimi i përpunimit të të dhënave ka të bëjë me një detyrë të interesit publik, gjë të cilën paditësja sipas pohimeve të saj në padi edhe e ka synuar, e njëjta nuk ka arritur që këtë qëllim ligjor ta arrij duke përdorur metoda të përshtatshme për të shmangur publikimin e numrit personal të subjekteve të cilëve ju ka referuar. Rrjedhimisht, përpunimi i tillë i të dhënave, ndonëse ka pasur parasysh përfundimin e një detyre me interes publik, është përcjellë me kundërligjshmëri, për çka e paditura me të drejtë e konform autorizimeve të veta ligjore, paditëses i kishte shqiptuar gjobën administrative si në dispozitiv të vendimit të atakuar me këtë padi.”

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.992/2023, datë;16.10.2024

Kryetari i kolegjit
Hajriz Hoti